



**LIGA
UNIKE**

LIGA UNIKE LIGA UNIKE E BASKETBOLLIT UNIQUE BASKETBALL LEAGUE			
Pranuar me dt. 24. 05. 2022			
Njësia org.	Numër	Nr. i ekzmpl.	Vlera
	07		

PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË BORDIT DREJTUES TË LIGËS UNIKE

17.05.2022, TIRANË

Kryetari i Bordit Drejtues të Ligës Unike, z. Ilir Trebicka fton mbledhje të Bordit Drejtues për datën 17 Maj 2022 (e martë) me fillim nga ora 10:00 në Tiranë me këtë:

Rend Dite:

1. Rrjedha e garave në edicionin e parë të Ligës Unike në të dyja konkurrencat. Çfarë ka qenë mirë, çfarë nuk ka qenë mirë dhe çfarë mund të bëhet më mirë në edicionin e radhës në aspektin e organizimit të garave (një analizë SWOT nga Bordi Drejtues).
2. Raporti Financiar nga Federata e Basketbollit e Kosovës dhe Federata Shqiptare e Basketbollit. Sa kanë shpenzuar secila Federatë për edicionin 2021/22 dhe që nga themelimi i Ligës. Të përgatiten dy raporte të ndara.
3. Cili është propozimi i Bordit Drejtues për organizimin e Ligës në edicionin e ri? Cili është propozimi nga të dyja Federatat? Si do të funksionoj zyra e Ligës?
4. Si do të arrijmë të térheqim sponsorë për Ligën Unike? Si duhet të veprojmë?
5. Takimi me zyrtarët më të lartë të Qeverisë Shqiptare për mbështetje financiare të Ligës për FSHB-në.
6. Propozim data për takimin e radhës të Bordit Drejtues të Ligës Unike, me prezencën edhe të dy Presidentëve të Federatave (FSHB dhe FBK).
7. Të ndryshme.

Sinqerisht,

Ilir TREBICKA

Kryetar

Bordi Drejtues i Liga UNIKE

17.05.2022, Tiranë

Të pranishëm në mbledhje të Bordit Drejtues ishin: Ilir Trebicka - Kryetar, Elvira Dushku - Anëtar, Vaso Shaka - Anëtar, Korab Llazani - Anëtar dhe Blerim Vuniqi - Anëtar.

I pranishëm në mbledhje (për një periudhë kohore) në cilësinë e mysafirit ishte edhe Presidenti i Federatës Shqiptare të Basketbollit (FSHB), Avni Ponari.

Mbledhja e Bordit Drejtues të Ligës Unique filloi në ora 10:30.

Kryetari i Bordit Drejtues, Ilir Trebicka i falënderoi anëtarët e Bordit Drejtues të Ligës Unique për prezencën e tyre në mbledhje dhe më pas e hapi mbledhjen duke kërkuar nga anëtarët të votojnë për miratim apo jo të rendit të ditës, ndërsa rendi i ditës u miratua unanimisht.

Në vazhdim Kryetari Trebicka tha se të gjitha materialet e mbledhjes së Bordit i janë dërguar anëtarëve të saj me kohë dhe më pas filloi me hapjen e diskutimit për çdo pikë të rëndit të ditës.

Në pikën e parë të rendit të ditës u diskutua për raportin e punës të garave të edicionit 2021/22 të Ligës UNIQUE në të dyja konkurrencat, dhe anëtarët nuk patën asnje vërejtje për këtë raport, të cilin edhe e miratuan.

U diskutua edhe për problemet e transmetimit të ndeshjeve në Shqipëri nga RTSH, ku pavarësisht kontratës së nënshkruar nga Liga me RTSH, kjo e fundit nuk e respekton një gjë të tillë, dhe arsyetimet e tyre janë se është për çështje teknike. U kerkua që të bëhet presion më i madh për të siguruar që në edicionin e ri, RTSH të respektoj kontratën, por që sipas zyrtarëve të FSHB-së vështirë se do të arrihet një gjë e tillë 100%.

Në pikën e dytë të rendit të ditës Kryetari Trebicka paraqiti dy raporte financiare të përgatitura nga Federatat themeluese të ligës, Federata Shqiptare e Basketbollit dhe Federata e Basketbollit e Kosovës për shpenzimet e tyre që nga themelimi i Ligës, pra viti 2020 e deri në përbillyje të këtij edicioni.



Sipas këtyre raporteve, Federata Shqiptare e Basketballit ka shpenzuar shumën prej 58,757 Euro, kurse Federata e Basketballit e Kosovës ka shpenzuar shumën prej 205,605.81 Euro.

Kryetari Trebicka i pyeti të pranishmit nëse kanë ndonjë koment apo vërejtje për këto dy raporte, por nuk pati, andaj Kryetari kërkoi nga anëtarja e Bordit Drejtues, Elvira Dushku që Menaxherja e Financave të Ligës Unike ti bashkojë këto dy raporte në një raport të vetëm financiar të ligës.

Në pikën e tretë të rendit të ditës u diskutua për mënyrën e funksionimit të ligës për edicionin e ri dhe pas diskutimeve të gjithë u dakordua se në rast të sigurimit të sponsorit apo sponsorëve të ligës, atëherë duhet punësuar një Drejtor të ligës i cili do të merret në baza ditore me punët e ligës dhe do të menaxhoj stafin e ligës dhe garat, kurse në rast të mos sigurimit të sponsorëve, atëherë liga të vazhdoj sikur në edicionin që e lamë pas, ku FBK ka caktuar persona nga zyra e saj ekzekutive për tu marr me punët e ligës dhe të njëjtën gjë e bën edhe FSHB. Për këtë çështje u la hapësirë që të diskutohet edhe në takimet e radhës të Bordit Drejtues të Ligës.

Në pikën e katërt të rendit të ditës Anëtarja e Bordit Drejtues, Elvira Dushku i informoi anëtarët për takimin me bankën BPB të realizuar në Prishtinë, në mes drejtuesve të kësaj banke dhe Kryetarit të FBK-së, Arben Fetahu, ku edhe ajo ishte vet e pranishme. Dushku i informoi anëtarët për ofertën që Liga Unike e ka bërë për bankën dhe se janë në pritje të përgjigjes, e cila besohet se do të vijë deri në javën e parë të muajit qershor (pozitive apo negative).

Në vazhdim u diskutua është për çështjen financiare të ligës, për diferencën e shpenzimeve të bëra nga të dyja Federatat, dhe për mundësinë më të madhe të tentimit të sigurimit të sponsorëve për ligë në Kosovë, falë edhe ligjit për sponsorizim i cili implementohet në Kosovë, ndërsa e njëjta gjë nuk ndodh në Shqipëri.



Në pikën e pestë të rendit të ditës u diskutua për ndikimin politik për Ligën Unike në Shqipëri, ku për dallim se në Kosovë, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka përkrahur financiarisht ligën, kjo nuk ka ndodhur në Shqipëri, dhe për këtë arsy Dushku e informoi Kryetarin Trebicka për kërkesën e bërë nga Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu në lidhje me mundësinë e realizimit të një takimi të përbashkët me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Edi Rama. Kryetari Trebicka premtoi se do të shikojë mundësinë e realizimit të këtij takimi dhe në të njëjtën kohë tha se në këtë takim duhet të shkohet sa më të përgatitur, kuptohet nga ana e Ligës UNIKE.

Pika e gjashtë e rendit të ditës kishte të bënte me takimin e radhës të Bordit Drejtues të Ligës UNIKE, ku të pranishëm pritet të jenë edhe Presidentët e të dyja Federatave themeluese. U vendos që pas 5 qershorit (përfundimit të garave në Kosovë) të mbahet takimi i radhës dhe se të gjithë do të njoftohen paraprakisht me kohë.

Kryetari Trebicka pyeti të pranishmit nëse kanë diçka për të shtuar, por anëtarët u pajtuan se u diskutuan të gjitha pikat me rëndësi dhe me këtë rast Trebicka konstatoi se mbledhja përfundoi në ora 12:00.

Përgatiti:

Elvira DUSHKU

Anëtare e Bordit Drejtues
Liga UNIKE

Miratoi:

Ilir TREBICKA

Kryetar
Liga UNIKE

